



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE PROJEKTEVE NË FUSHËN E DREJTËSISË, INTEGRIMIT DHE NEGOCIATAVE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE NË FUSHËN E DREJTËSISË**

Raport konsultimi i draft raportit të monitorimit për periudhën janar-dhjetor 2021, të Planit të veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025

1. Titulli i draft aktit: Raporti i monitorimit për periudhën janar-dhjetor 2021, Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021-2025.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

- Konsultimi i parë (*drafti 1*) me institucionet zbatuese e raportuese të Planit të Veprimit dhe Departamentin e Mirëqeverisjes dhe Zhvillimit në KM, ka zgjatur 10 ditë pune (nga data 18 mars – 30 mars 2022). Draft raporti është shpallur për konsultim në web të Ministrisë së Drejtësisë. Publikimi është bërë në datë 18.11.2022, në menu: prioritet/strategjia ndërsektoriale/strategjia e ndërsektoriale e drejtësisë/raporte monitorimi në www.drejtësia.gov.al
- Konsultimi i dytë (*drafti 2*) me institucionet zbatuese e raportuese të Planit të Veprimit dhe Departamentin e Mirëqeverisjes dhe Zhvillimit në KM, është dërguar (i plotë) për rishikim, vlerësim kontributi dhe finalizuar me zhvillimin e takimit të dedikuar të konsultimit në datë 31.03.2022.

3. Metoda e Konsultimit

Metoda e konsultimit të përdorur për këtë draft raport janë si më poshtë vijon:

- Dërguar *via email* institucioneve përgjegjëse e zbatuese të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe Departamentit në KM/ dërguar formati i raportimit për plotësim me shpjegimet dhe detajet e kërkuara. Dërguar formati i raportimit (për masat dhe aktivitetet).
- Komunikimi i drejtpërdrejtë *via email* për çdo kontribut/raportim të marrë; kthim për plotësim informacioni, të dhënash, informacioni i munguar dhe komente të ardhura nga data 27.01.2022– 10.03.2022.
- Faqja zyrtare e MD-së, www.drejtësia.gov.al
- Tryezë konsultimi e diskutimi teknike, (online) me pjesëmarrës nga të gjithë institucionet përgjegjëse të SND-së. Takim i realizuar në datë 31.03.2022, Komitet Drejtues Sektorial.



Kontributet në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit së të dhënave dhe përmbajtjes së draft raportit, u përcollën:

- nëpërmjet pikës së kontaktit të përcaktuar për dërgim kontributi anairda.arizaj@drejtesia.gov.al;
- nëpërmjet komenteve të drejtpërdrejta në tryezën e konsultimit të zhvilluar në MD (online).

Gjithashtu Ministria e Drejtësisë shpalli për konsultim publik draft raportin e monitorimit janar-dhjetor 2021, të Planit të Veprimit, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, 2021-2025 edhe për OSHC-të, duke pritur komente, mendime dhe sugjerime nga ta brenda datës 30 mars 2022, në adresën anairda.arizaj@drejtesia.gov.al

4. Palët e interesit të përfshira

Draft raporti është konsultuar me përfaqësues të të gjithë institucioneve publike përgjegjëse për zbatimin e PV të SND-së dhe të grupeve të interesit.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/të refuzuara

Çështja e adresuar	Palët e interesuara	Vendimi (i pranuar/ i pranuar pjesërisht/ i refuzuar)	Justifikimi
Reflektimi i komenteve në kuadër të përmirësimit të draft raportit	Departamentin e Mirëqeverisjes dhe Zhvillimit në KM	Reflektuar komentet mbi pikën 1.4, 2.4, 5.1, 5.2, 5.3 Pa reflektuar komentet mbi pikën 1.2, 1.3 të cilat do të mbahen në konsideratë në raportimin e rradhës	Janë reflektuar komentet sipas informacionit të dërguar
Kërkohej reflektimi i komenteve mbi masën e përcaktuar dhe indikatorin.	Komisioni i Pavarur i Apelit	Reflektuar komentë mbi indikatorin	Target i vendosur do të jetë pjesë e analizës për vitet në vijim vetëm për Komisionin e Pavarur



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

			të Kualifikimit. Raportimi i Kolegjit i Posaçëm i Apelit bazuar në organizimin dhe funksionim e tij do të konsistojë vetëm në të dhënat statistikore lidhur me ecurinë e procesit të rivlerësimit si dhe koston në buxhet të aktivitetit të parashikuar për vitin përkatës.
Kërkohet plotësim informacioni në objektivin 1.3, konkretisht masën 1.3.1 sipas Planit të Veprimit	Këshilli i Lartë i Prokurorisë	I pranuar	Është reflektuar plotësimi i informacionit të dërguar në raport
Kërkohet reflektim i komenteve për masën 2.2.4	Gjykata Kushtetuese	I pranuar	Është reflektuar plotësimi i informacionit të dërguar në raport